



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 2295 Prot.

Tiranë, më 20.05.2026

**Lënda :** Propozim për shqyrtim dhe miratim projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 82 datë 26.07.2024 “Për Policinë e Shtetit”.

**Drejtuar:**

**Z. NIKO PELESHI**  
**KRYETAR I KUVENDIT**

I nderuar z. Kryetar,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 82 datë 26.07.2024 “Për Policinë e Shtetit”, shoqëruar me relacionin përkatës.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**DEPUTET**

**Bujar REXHA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_/\_\_/2026

**PËR**

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 82, DATË 26.07.2024 “PËR  
POLICINË E SHTETIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 82 datë 26.07.2024 “Për Policinë e Shtetit” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

**Neni 1**

Në nenin 46 bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Shërbimet e Policisë së Shtetit organizohen në departamente, drejtori qendrore dhe vendore, struktura të veçanta, struktura tekniko-shkencore, teknologjike dhe të informacionit, komisarate, sektorë, njësi dhe stacione policore, që ushtrojnë veprimtarinë në nivel qendror dhe vendor, sipas shpërndarjes territoriale, në varësi të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit, garanton që këto shërbime do të mbështeten me kapacitete njerëzore, financiare, administrative, operacionale dhe logjistike për ushtrimin e shërbimeve policore në secilin nivel organizativ”

2. Pika 3, shfuqizohet.

3. Pika 4, shfuqizohet.

4. Pika 6, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“6. Numri i personelit të Policisë së Shtetit miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit”

#### **Neni 2**

Në nenin 48, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Departamenti është strukturë administrativo-operacionale dhe organizohet në nivel qendror.”

#### **Neni 3**

Në nenin 49, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtoria vendore është strukturë administrative dhe operacionale e Policisë në nivel vendor.”

2. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtoria vendore e policisë përbëhet nga komisariat/e, stacion/e dhe postë/a policore”.

#### **Neni 4**

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 50

#### **Komisariati**

Komisariati i policisë është strukturë bazë administrative, operacionale dhe hetimore në varësi të drejtorisë vendore dhe ushtron përgjegjësitë e policisë në territorin që ka në juridiksion.”

#### **Neni 5**

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

### **Stacioni i policisë dhe posta policore**

Stacioni i policisë është njësi policore administrative, operacionale dhe hetimore në varësi të komisariatit ose në raste të veçanta, kur nuk ka komisariat, në varësi të drejtorisë vendore të policisë. Stacionet mund të jenë të përhershme ose të përkohshme. Në varësi të dinamikës së lëvizjeve demografike dhe sezoneve turistike ngrihet “postë policore”, e përhershme ose e përkohshme”

#### **Neni 6**

Në nenin 53, pika 1, togfjalëshi “sistemin e drejtësisë penale” zëvendësohet me “ sistemin e drejtësisë”.

#### **Neni 7**

Në nenin 56, pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, pas lirimit nga detyra, rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit dhe i jepet grada “Drejtues i Parë”, pa të drejtë riemërimi si drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Në interes të shërbimit të rendit dhe të sigurisë publike, ai mund të kryejë funksione drejtuese këshillimore, pedagogjike ose i atashuar si oficer kontakti. Me përfundimin e qëndrimit në detyrë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit gëzon trajtim të veçantë, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave”.

#### **Neni 8**

Në nenin 58, pika 2 ndryshohet si vijon :

“2. Zëvendësdrejtori kryen detyrat që i delegohen nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit”.

#### **Neni 9**

Në nenin 59, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1.Fjalja e dytë e pikës 2 ndryshohet si vijon :

“2. ...Drejtori i përgjithshëm i propozon ministrit, kandidatin e zgjedhur bazuar në parimet e mundësive të barabarta, të meritokracisë dhe të mosdiskriminimit. Rregullat e procedurat për përzgjedhjen e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përcaktohen me udhëzim të ministrit”.

2. Pika 4, ndryshohet si vijon:

“4.Rastet e lirimit e të shkarkimit, si dhe mandati i qëndrimit në detyrë për zëvendësrejtoren e përgjithshëm të Policisë së Shtetit janë të njëjta me ato të drejtorit të drejtorit të departamentit”.

#### **Neni 10**

Në nenin 60, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Drejtori i departamentit është autoriteti më i lartë i shërbimit policor të departamentit që drejton”.

2. Në pikën 3, gërma “c”, ndryshohet si vijon:

“c) propozon buxhetin e departamentit që drejton”.

3. Pika 5 ndryshohet si vijon :

“5. Drejtori i departamentit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe qëndron në detyrë për një mandat 3 vjeçar, me të drejtë riemërimi për një mandat të dytë. Drejtori i përgjithshëm i propozon ministrit kandidatin e zgjedhur bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit dhe që plotëson kriteret ligjore. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të departamentit përcaktohen në rregulloren e Policisë së Shtetit.”

#### **Neni 11**

Në nenin 61, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ dhe operacional i policisë në nivel vendor dhe përgjigjet te drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit”.

2. Paragrafi i parë i pikës 3, ndryshohet si vijon:

“3.Drejtori i Drejtorisë Vendore përzgjidhet nga radhët e rolit të mesëm drejtues, nëse plotëson njëkohësisht kriteret si më poshtë:”

3. Pika 4, ndryshohet si vijon:

“4. Drejtori i Drejtorisë Vendore emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

#### **Neni 12**

Në nenin 62, bëhen ndryshimet si vijon:

1.Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

3. Shefi i komisariatit përzgjidhet nga rradhët e punonjësve të policisë që mbajnë gradën “komisar/kryekomisar” dhe që plotësojnë kriteret si më poshtë:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të mos ketë masa në fuqi për shkelje të rënda disiplinore të policisë;
- c) të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- ç) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i tij bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.”

5.Pika 4, ndryshohet si vijon:

“4. Procedurat e përzgjedhjes së shefit të komisariatit të policisë përcaktohen në rregulloren e Policisë.”

### **Neni 13**

Në nenin 66, pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese. Numri dhe tabela e funksioneve korresponduese për çdo gradë dhe kategorizimi i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

### **Neni 14**

Në nenin 85, në fund të pikës 4.shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“...Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, i jep punonjësit të policisë, gradën pasuese, mbi bazën e vlerësimit të demonstrimit të një profesionalizmi të lartë të punonjësit, të kryerjes së një akti me karakter heroik, të një veprimi që tejkalon pritshmëritë në situata të rrezikshme dhe të paparashikueshme, apo të dhënies së kontributit të drejtpërdrejtë në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, në shënjë mirënjohje dhe vlerësimi, me propozim të eprorit të punonjësit. Numri i gradave të dhëna sipas kësaj pike, nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) për qind i limitit të përgjithshëm të gradave policore.”

### **Neni 15**

Në nenin 86, pika 1, gërma “dh” , nëndarjet “iii” dhe “iv”, ndryshojnë si vijon:

- |                                      |          |
|--------------------------------------|----------|
| “iii. nga “komisar” në “kryekomisar” | 4 vjet;  |
| iv. nga “kryekomisar” në “drejtues”  | 4 vjet;” |

#### **Neni 16**

Në nenin 127, pika 3 ndryshohet si vijon:

“3. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep edhe certifikata për personelin e policisë.”

#### **Neni 17**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**NIKO PELESHI**

## RELACION

### PËR PROJEKTLIGJIN

#### “ PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGIN NR.82/2024 “PËR POLICINË E SHTETIT”

Ndryshimet e propozuara lidhen harmonikisht me organizimin, drejtimin dhe kontrollin vertikal dhe shtrijes horizontale të shërbimeve policore. Kjo ndërthurje e këtyre koncepteve organizimi, i referohet natyrës së shërbimeve dhe veprimtarisë së strukturave policore.

Problematikat e hasura në zbatim të ligjit nr 82/2024, nuk i kanë shpëtuar as syrit kritik dhe zhvillues të medias, po ashtu edhe zbatuesve të këtij ligji, për ngërçin e krijuar dhe aq shumë të diskutuar që lidhet me procesin e konkurrimit në përzgjedhjen e drejtuesve të strukturave të Policisë së Shtetit. Të ndodhur në këtë pozicion, që na jep të drejtën për të shprehur dhe përcjellë çdo shqetësim publik, gjej mundësinë të shpreh se procedura e përzgjedhjes së drejtuesve të strukturave të nivelit të lartë policor, është kthyer në pengesë në vetë ushtrimin e veprimtarisë së tyre, kanë ulur ndjeshëm reagimin dhe produktivitetin e veprimtarisë qoftë administrativ po ashtu dhe atë operativ, për shkak të një procesi konkurrimi të tejzgjatur në kohë dhe pa produktivitet përzgjedhje. Zhvillimi i këtij procesi, ka shtuar procedurat burokratike, formale dhe aspak efektive për përzgjedhjen e drejtuesve në pozicione të larta drejtuese, atë të zëvendës drejtorit të përgjithshëm, drejtorit të departamentit, drejtuesit vendor dhe deri tek shefi i një komisarati. Konkurrimi në vetvetë, është pjesë e një procesi demokratik dhe meritokratik përzgjedhje, por në rastin konkret, është një proces që nuk i ka shërbyer kësaj organizate me tipare të veçanta të administratës publike, si në misionin që ka dhe në formën organizative të saj.

Kronikat e përsëritura mediatikë kanë ekspozuar se procedurat e shumta të deritanishme të konkurrimit për pozicionet e larta drejtuese, si zëvendës drejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtues vendor dhe shef komisarati, përveç se janë procedura të tej zgjatura administrative, shpesh janë kthyer në pengesë për reagimin e shpejtë operacional të Policisë së Shtetit.

Media, ka sjellë në vëmendje dëshmi që ngrenë pikëpyetje mbi zbatimin e ligjit dhe kjo problematikë ka diktuar nevojën për një sistem të ri, që zëvendëson burokracinë e tejzgjatur me përgjegjshmërinë e drejtpërdrejtë, duke garantuar që emërimet në krye të këtyre pozicioneve t'i përgjigjen me shpejtësi dinamikës së krimit dhe nevojës së shoqërisë, pa u bërë pengesë e procedurave.

-Nga një analizë e situatës konkrete, konstatohet se një drejtues vendor shkarkohet nga detyra, duke çuar në një spirale “komandimesh” që zgjasin pafundësisht në pritje të shpalljes së konkurremeve. Kjo praktikë e konkurremeve të shpeshta po krijon një rotacion të pasigurt, ku fituesi i ri, e gjen veten në një ambient të de motivuar, duke e paraditur që është i përkohshëm deri në përzgjedhjen e drejtuesit të ri. Statusi “i komanduar” i punonjësit të policisë, krijon një gjendje pasigurie, për të gjithë ekipin, pasi një drejtues i përkohshëm nuk arrin në kohë të ndërtojë autoritetin e plotë.

Zëvendësimi me “të komanduar” krijon status “përkohshmërie”, që pengon kontrollin efektiv të territorit, sjell mungesë stabiliteti dhe humbje autoriteti. Të gjitha këto, vijnë si pasojë e procedurave të tejzgjatura të procesit të konkurrimit, të panevojshme dhe me kosto administrative dhe sigurie. Një ekip, që të japë rezultate, duhet të ketë mbështetje dhe mirëbesim në vijë hierakike dhe organizative.

Heqja e procedurës së konkurrimit për këto pozicione, duke parashikuar emërimin e tyre pa konkurrim formal, diktohet nga nevoja për fleksibilitet operacional dhe përgjegjësisë së lartë institucionale që kanë, duke shmangur afatet e procedurës administrative, në kushtet kur për natyrën e institucionit të PSH, kërkohet reagim i shpejtë, drejtim efektiv dhe funksionim i pandërprerë i zinxhirit komandues në Policinë e Shtetit.

Procedura e konkurrimit për këto funksione parashikohet në nenin 59 “Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit”, nenin 60 “Drejtori i departamentit, përgjegjësitë, kriteret e emërimit, të lirit të të shkarkimit të tij”, nenin 61, “Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, përgjegjësitë, kriteret e emërimit, të shkarkimit e të lirit të tij” dhe nenin 62 “Shefi i komisariatit, përgjegjësitë, kriteret e emërimit, të lirit dhe të shkarkimit të tij”, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit të ri të Policisë së Shtetit, lidhur me procesin e konkurrimit në pozicionet drejtuese, është konstatuar mospërputhje serioze ndërmjet asaj që kemi shkruar në letër dhe shtrirjes faktike të strukturës në territor, që lidhet me modelin e drejtimit vertikal.

Modeli i drejtimit vertikal, kërkon ndarjen e prerë të shërbimit të rendit nga shërbimi i hetimit të krimit, e cila nuk është reflektuar në strukturën faktike të Policisë së Shtetit, sepse në terren ka rezultuar i pazbatueshëm.

Pamundësia për zbatueshmëri, lidhet me faktin se policia është një institucion operativ, jo një strukturë administrative tipike burokratike. Modeli vertikal sjell vonesa në vendimmarrje dhe një centralizim të panevojshëm, të ndarë gjithashtu dhe pa një dorë drejtuese.

Në vend që të kemi ndërveprim të shpejtë, ky model kërkon që çdo vendim të ngrihet lart në hierarki, duke thyer bashkëpunimin mes strukturave. Nuk mund të lejohet që një operacion policor të presë vendimmarrjen e një vargu hierarkik, ndërkohë që siguria cenohet në kohë reale dhe reagimi duhet të jetë imediat.

Gjithashtu, për të mos u nënvlerësuar janë edhe efektet financiare të papërbalueshme dhe jo proporcionale, që shoqërojnë këtë lloj organizimi strukturor. Zbatimi i plotë i kontrollit vertikal do të kërkonte ndarjen fizike të Drejtorive Vendore, në një godinë me dy drejtues/autoritet, një për shërbimin e rendit dhe një tjetër për hetimin e krimit.

Kjo do të thotë jo vetëm dublim kompetencash por edhe dublim i zyrave, i logjistikës dhe kosto shtesë në buxhet, të cilat nuk përkthehen në më shumë siguri, por në më shumë administratë. Aktualisht, modeli i integruar nën një drejtor të vetëm vendor, i cili mban llogaridhënien finale është dëshmuar si më efikas.

Përballë këtij realiteti, ky projektligj synon të korrigjojë këtë problematikë ligjore.

Propozohet rishikimi për kalimin drejt një drejtimi hibrid, ashtu siç ka funksionuar dhe funksionon realisht sot, me një autoritet të vetëm vendor që koordinon zëvendës drejtorët e strukturave, sipas fushave.

Drejtoritë vendore, duhet të kenë kompetencën territoriale dhe vendimmarrjen direkte, duke shmangur mbivendosjen e kompetencave që rrezikon eficiencën operacionale. Terreni kërkon bashkëpunim dhe shpejtësi. Ky rishikim i kontrollit vertikal është i domosdoshëm që policia të ketë stabilitetin drejtues, duke u bazuar te rezultatet dhe jo në teori që rëndojnë buxhetin.

Mbi bazën e argumentave sa më sipër, propozohet analiza për ndryshime në nenet 46, 48, 49, 50, 60 dhe 61, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

- Pasi sqaruar nevojën për një model drejtimi hibrid dhe eficient, duhet të adresojmë një tjetër problematikë themelore të konstatuar gjatë rishikimit të organizimit strukturor, në nenin 46, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Ky nen, ka mangësi logjike dhe juridike. Ai i jep ministrit të brendshëm kompetencën të miratojë numrin e personelit për çdo departament apo drejtori, por nuk parashikon elementin bazë se kush autoritet përcakton numrin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, neni 66, parashikon se me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohet hierarkia e gradave dhe funksioneve për gradë, por pa përcaktuar numrin total zyrtar të punonjësve që do t'i mbajnë këto grada.

Pa një numër total të saktë, nuk mund të bëhet llogaritja e saktë të gradave. Kjo pengon shpërndarjen e drejtë të funksioneve në territor.

Nga analiza e këtij neni përballemi dhe me një problem që lidhet me hierarkinë e normës. Nuk mundet që një urdhër ministri që përcakton numrin e punonjësve në mënyrë të diferencuar, të diktojë më pas ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave për të përcaktuar shpërndarjen e funksioneve sipas gradave.

Ky parashikim aktual rrezikon të kemi një strukturë “*të cenueshme*” që ndryshohet lehtësisht me urdhra ministri, ndaj lind nevoja e saktësisht të numrit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit me vendim të Këshillit të Ministrave. Vetëm duke pasur një numër total të miratuar, mund të garantojmë stabilitet të gradave, që çdo gradë t'i përgjigjet një funksioni real dhe planifikim buxhetor, që çdo shtim personeli të jetë i parashikuar dhe jo i varur nga vullneti i momentit.

-Një pikë tjetër, jo më pak e rëndësishme në këtë rishikim ligjor, lidhet me statusin e Drejtorit të Përgjithshëm pas përfundimit të mandatit, e parashikuar në nenin 56, të ligjit të PSH. Ligji aktual përmban një paradoks, ku nga njëra anë kërkohet që Drejtori i Përgjithshëm të jetë një profesionist karriere, por sapo ai përfundon mandatin, del jashtë sistemit.

Kjo bie ndesh me nenin 7, të ligjit të Policisë së Shtetit, i cili garanton zhvillimin e karrierës profesionale. Nuk mund të pretendojmë integritet dhe përkushtim maksimal, nëse institucioni i kthen shpinën drejtuesit të tij më të lartë sapo përfundon afati i qëndrimit në detyrë.

Një ish-Drejtor i Përgjithshëm nuk është thjesht një emër, por përfaqëson një investim dekadash të shtetit, me njohuri të larta akademike dhe eksperiencë edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Vlerësimi për krijimin e hapësirave ligjore për vijimin e tij në strukturat policore, mundëson që kjo eksperiencë të mos humbasë, por të përdoret në funksione këshillimore, pedagogjike në Akademi, apo si oficer kontakti. Kjo i përgjigjet nevojës që dija menaxheriale të vijojë t'i shërbejë institucionit, pa cenuar autoritetin e drejtuesit pasardhës.

-Ndalem, më tej në një pikë që prek drejtpërdrejt motivimin dhe ecurinë e punonjësve të policisë në terren. Gjatë analizës së zbatimit të ligjit, konkretisht në nenin 86, konstatohet se afatet e qëndrimit në gradat “Komisar” dhe “Kryekomisar” shihen si pengesë për zhvillimin e karrierës. Një afat prej 5 vitesh për secilën gradë, vlerësohet më shumë si kriter formal dhe i tejzgjatur, duke krijuar një demotivim të profesionistët që prodhojnë rezultate.

Në këtë këndvështrim, me synimin për një sistem më fleksibël, vlerësohet ulja e afatit të qëndrimit në këto grada, duke shmangur kohën si element formal dhe zhvendosur fokusin te performanca.

Nuk ka sens që një punonjës policie i zoti, i cili jep rezultate në hetimin e krimit apo në rendin publik, t'i nënshtrohet një afati kaq të gjatë, ndërkohë që ka nevoja emergjente për të plotësuar vendet vakante në nivelin drejtues. Ky ndryshim i hap rrugën rolit të mesëm drejtues, gradës “Drejtues”, të rigjenerohet me punonjës që janë në kulmin e tyre profesional.

Kjo shmang nevojën për “komandime” të detyruara nga mungesa e gradës dhe i jep Policisë së Shtetit një trupë drejtuese legjitime dhe të motivuar.

Si përfundim, vlerësohet që karriera në këtë institucion të bazohet te merita dhe shpejtësia e rezultateve, jo te pritja pasive e vjetërsisë në punë. Ky institucion ka nevojë për drejtues dinamikë.

- Sa më sipër, u diskutua për afate, struktura dhe konkurrime, që janë të gjitha procese administrative. Policia e Shtetit nuk është thjesht një administratë, por një organizatë që përballet çdo ditë me rrezikun e jetës.

Gjatë shqyrtimit të nenit 85, konstatohet se sistemi aktual i fitimit të gradës është “mekanik”, me konkurrime dhe afat. Vlerësojmë, se ligji duhet t'i japë Drejtorit të Përgjithshëm një mundësi ligjore, që në raste të jashtëzakonshme, të veprojë me forcën e mirënjohjes. Gjej me vend propozimin që në këtë nen, të parashikohet e drejta e Drejtorit të Përgjithshëm për të dhënë një gradë më të lartë në shenjë vlerësimi për akte heroike, sakrificë apo rrezikshmëri të lartë të ndërmarrë në shërbim të rendit dhe luftës kundër krimit. Ky është momenti i njohjes dhe vlerësimit të kontributit real dhe të prekshëm.

Ky ndryshim nuk cenon garën, por e lartëson atë. Ai i jep Drejtorit të Përgjithshëm instrumentin e duhur për të motivuar të gjithë organizatën. Një gradë e dhënë për meritë të jashtëzakonshme vlen edhe për punonjësit e tjerë, në kuptimin që sakrificë e tyre shihet, vlerësohet dhe shpërblehet.

- Gjatë punës mbikëqyrëse dhe nga ankesat nga radhët e administratës së Policisë, konstatohet një trajtim i diferencuar, në përcaktimet e nenit 127. Nëpunësit civilë dhe administrativë, të cilët janë mbështetja logjistike, juridike dhe teknike pa të cilën Policia nuk do të funksiononte, shpesh ndihen të pavlerësuar dhe pa shpërblyer.

Institucioni i Policisë së Shtetit është unik, një i vetëm dhe i pandarë. Nëse një operacion i policisë është i suksesshëm, kjo vjen edhe falë punës së këtyre punonjësve. Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm duhet të ketë të drejtën të japë certifikata vlerësimi për çdo punonjës pa dallim statusi “policor” apo jo.

Ky ndryshim do të garantojë trajtimin e barabartë dhe shmang diskriminimin brenda të njëjtit vend pune, duke i dhënë mundësinë edhe personelit civil të pajiset me certifikata vlerësimi dhe për rrjedhojë rritjen e moralit të punës në të gjitha nivelet.

**DEPUTETI**

BUJAR REXHA

